

Ekskluzive

Ekskluzive | Fejesa i kushton me 48 orë ndalim 50-vjeçarit në Suharekë – Policia dëgjoi krismat derisa po kontrollonte trafikun



Sinjali.com

16 Gusht 2026 17:31



Një aheng familjar në Suharekë është shoqëruar me të shtëna me armë zjarri, ndërsa ndërhyrja e Policisë ka përfunduar me sekuestrimin e armës dhe ndalimin e një 50-vjeçari, mëson Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se i dyshuari është **Avdi Elshani 50-vjeçar**.

Rasti ka ndodhur sot, më 16 gusht, rreth orës 10:55, në rrugën “Festari” në Suharekë.

Sipas informacioneve që ka mësuar Sinjali, zyrtarët policorë po kryenin një kontroll në trafik kur kanë dëgjuar të shtëna me armë zjarri dhe janë vënë menjëherë në lëvizje për të lokalizuar vendin nga vinin krismat.

Pas mbërritjes në lokacion, Policia ka kontaktuar me Elshanin, i cili gjatë bisedës ka pranuar se kishte shtënë me armën e tij gjatë një ahengu familjar – konkretisht një fejese.

Bëhet fjalë për një pistoletë “Steyr M9-A1”, të kalibrit 9 mm, së bashku me një karikator. Sipas të dhënave të rastit, Elshani posedon leje për mbajtjen e armës.

Megjithatë, posedimi i lejes nuk e ka shpëtuar nga procedurat penale për përdorimin e saj.

Pas konsultimit me Prokurorin e Shtetit nga Departamenti i Përgjithshëm, ndaj 50-vjeçarit janë iniciuar rastet për “Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm” dhe “Përdorim të armës”.

Me vendim të Prokurorit, Avdi Elshani është ndaluar për 48 orë.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera